



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Podato Received / Delivery	27.10	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Pril Bil Pril Pril No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHK	6724/2023		116	



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1196/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1196/2023 të datës 22.09.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted] kundër Njoftimit të datës 13.09.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.10.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1196/2023 e datës 22.09.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

### A r s y e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 14.03.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me numër Reference RN00011216 për pozitën Sekretar i Përgjithshëm 1 për Ministrinë e Mbrojtjes, ku është përcaktuar afati për aplikim nga data 13.04.2023 deri më datë 20.04.2023. Në këtë konkurs kanë aplikuar nëntë (9) kandidatë në mesin e tyre dhe ankuesi, ndërsa pas verifikimit paraprak të datës 27.04.2023 vetëm dy (2) kandidatë kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Meqenëse në këtë procedurë ka pasur ankesa në fazën e verifikimit paraprak e të cilat janë shqyrtuar edhe nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,

procedura është pezulluar dhe pas shqyrtimit të të gjitha ankesave, më datë 31.08.2023 është publikuar njoftimi që pas përfundimit të ankesave lista e ngushtë mbetet e njëjtë, ndërsa kandidatët e listës së ngushtë janë njoftuar për testin me shkrim i cili është mbajtur me datë 11.09.2023, ndërsa intervista me gojë është mbajtur më datë 12.09.2023 me dy kandidatë të cilët kanë qenë në listën e verifikimit paraprak dhe të cilët kanë kaluar testin me shkrim.

Sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesi në testin me shkrim ka marr gjithsej 35.6 pikë ndërsa në intervistë me gojë 28.9 pikë dhe me gjithsejtë nga të dyja fazat 64.5 pikë, që rezulton si kandidat që nuk ka marr numrin e pikëve për të qenë kandidati fitues. Duke marr parasysh që në këtë procedurë vetëm një kandidatë ka arritur të marr më shumë së 70 pikë, atëherë Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 13.09.2023 ka publikuar njoftimin për ndërprerjen e procedurës për arsye se nuk janë identifikuar dy konkurrenca me më së paku 70% të pikëve.

Më datë 14.09.2023 ankuesi përmes emailit është njoftuar për rezultatin e testit me shkrim, intervistës me gojë dhe rezultatit përfundimtar.

Ankuesi, kundër këtij njoftimi, me datë 22.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6191/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 25.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli më datë 02.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 6191/2023 të datës 22.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 28.04.2023 nga [redacted] për ankuesin; Njoftimin e datës 27.04.2023 për listën e verifikimit paraprak; Emailin e datës 17.05.2023 nga [redacted] për ankuesin lidhur me pezullimin e procedurës; Emailin e datës 15.08.2023 nga [redacted] për ankuesin; Vendimin me Nr. prot: 1270 të datës 10.08.2023; Njoftimin e datës 31.08.2023 për listën e verifikimit paraprak; Emailin e datës 04.09.2023, 07.09.2023 nga [redacted] për ankuesin; Njoftimin e datës 12.09.2023 nga SIMBNJ për ankuesin për rezultatin e testit me shkrim; Njoftimin e datës 12.09.2023 nga SIMBNJ për ankuesin për rezultatin e intervistës me gojë; Emailin e datës 14.09.2023 nga [redacted] për ankuesin lidhur me njoftimin për ndërprerjen e procedurës; Njoftimin e datës 13.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.09.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 02.10.2023; Konkursin me numër Reference RN00011216 për pozitën *Sekretar i Përgjithshëm 1* për Ministrinë e Mbrojtjes të datës 14.03.2023 të shpallur nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr. 04/73 të datës 30.04.2023 për emërimin e Komisionit

Shtetëror të Pranimit; Vendimin me Nr. 04/41 të datës 28.04.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 30.04.2023; Listën e aplikantëve; Vendimin me Nr. 06/145 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 28.04.2023; Listën e renditjes përfundimtare të kandidateve e datës 12.09.2023; Lista e pyetjeve të intervistës me gojë; Emailin e datës 30.05.2023 nga ankuesi për Aplikacionin e ankuesi i datës 19.04.2023, Diplomën me Nr. 551, Shtojcën e Diplomë me Nr. Port:1304, Vërtetimin e datës 01.09.2011, Vendimin me Nr. 05/84 të datës 15.04.2016, Vërtetimin e datës 25.08.2022, Vërtetimin me Nr. 107/2023 të datës 14.04.2023, Rekomandimin e datës 15.06.2020, Letër Motivimi e datës 18.04.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 16.04.2023, Dokument identifikimi, CV-në, Letër rekomandimi e datës 29.06.2020, Referencë e datës 03.01.2007, Certifikatën MO7110, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për 01.01.2017-14.04.2023, Certifikatën e datës 30.11.2000, Certifikatën 05-07.06.2018, Certifikatën për 11-15.03.2019, Certifikatën për 13-31.05.2019, Certifikatën për 04-08.11.2019, Certifikatën për 24-28.02.2020, Certifikatën për 02-06.03.2020, Certifikatën për 04-22.10.2021, Certifikatën për 05-07.04.2022, Certifikatën për 23-26.05.2017, Licencë e darës 18.01.2004, Certifikatën e datës 21.02.2001, 15.03.2001, Diplomën Me Nr. 26, Certifikatën për 11-13.09.2001, Vërtetim me Nr. prot: 181/10 të datës 15.10.2011, Letër rekomandimin e datës 09.01.2007, Certifikatën për 18-20.10.2016, Vërtetim i datës 18.12.2002, Vendimin me Nr. 02/67 të datës 26.02.2021, Vendimin me Nr. 05/96 të datës 22.06.2016; Aplikacionin e kandidati të datës 13.04.2023, Diplomën me Nr. 970, Diplomë me Nr. 1263, Certifikatës nga Universitet i Teknologjisë në Vjen e datës 10.11.2006, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 08.02.2023, Letër motivimi prill 2023, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 12.03.2008 deri 06.04.2023, Vërtetimin e datës 05.06.2020, Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 10.06.2019, Vërtetimin për përvojën e punës i datës 02.06.2022, Vendimin Ref.DBN-MM-5/77/2023 i datës 01.02.2023, Shkresë e datës 31.05.2012, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 02.03.2023, 31.01.2022, Certifikatën nëntor 2022, Certifikatën tetor 2022, Certifikatën dhjetor 2015, Certifikatën e datës 20.12.2015, Certifikatën e datës 21.11.2013, Certifikatën tetor 2020, Certifikatën për periudhë 23.03.2012 deri 31.05.2012, Certifikatën për periudhën 30.04.2012 deri 22.05.2021, Dëshmi për masat disiplinore e datës 13.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e pa bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 13.09.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, pretendon se vlerësimi i intervistës me gojë nuk është bërë në raport me përgjigjet e dhëna pasi që vlerësimi nuk ka qenë korrekt dhe i saktë.

Bazuar në konkursin me numër Reference RN00011216 për pozitën *Sekretar i Përgjithshëm 1* për Ministrinë e Mbrojtjes të shpallur më datë 14.03.2023 nga Departamenti për

Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kërkesat e përgjithshëm formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit ë lartë me së paku 4 vite të studimeve. E preferuar në fushat që ndërlidhen më fushëveprimtarin e institucionit ku rekrutohet.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me nenin 11, nenin 40 paragrafi 5 nën paragrafi 5.1 dhe paragrafin 6 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve për këtë pozitë ku në bazë të listës së kandidatëve ka përfshirë dy (2) kandidatë, si rrjedhojë pas procedurës së vlerësimit sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ka përfunduar procedurën me vetëm një (1) kandidatë fitues me më shumë së 70 pikë respektivisht më 76.2 pikë, ndërsa ankuesi është renditur i dyti me 64.5 pikë duke mos u rekomanduar si kandidatë fitues.

Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së procedurës së rekrutimit për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm 1" për Ministrinë e Mbrojtjes, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka vlerësuar që verifikimi paraprak i kandidatëve është bërë brenda afateve të përcaktuar me konkurs si dhe brenda afateve të përcaktuara me dispozitat e paragrafit 4 të nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, po ashtu janë respektuar edhe afatet tjera procedurale të procedurës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë procedurë i është referuar nenit 40 paragrafi 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: "8. Jo më shumë se tre (3) kandidatët e vlerësuar, nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Me emrat e kandidatëve fitues njoftohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ata bëhen publik nga Njësia e pranimit në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ-së dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Kandidatët që nuk janë fitues njoftohen personalisht dhe kanë të drejtën e ankimit në KPMSHCK, në afat kohor 8 dite kalendarike. 9. Në rast se procedura e konkurrimit përfundon pa të paktën dy kandidatë fitues të vlerësuar me më shumë se 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet një procedurë e dytë konkurrimi. Procedura e dytë e konkurrimit është e hapur dhe në të mund të marrë pjesë çdo kandidat, që i plotëson kërkesat e përgjithshme për pranimin në kategorinë e lartë drejtuese dhe kërkesat e posaçme për pozitën përkatëse nga brenda apo jashtë Shërbimit Civil. 10. Në rast se edhe procedura e dytë nuk sjell të paktën dy fitues, një procedurë e tretë konkurrimi, gjithashtu e hapur, organizohet pas një periudhe 3 (tre) muajore", ndërsa sipas nenit 13 paragrafi 15 dhe 16 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, është përcaktuar se: "15. Komisioni, në bazë

*të vendimit si në paragrafin 14 të këtij neni përgatit listën e kandidatëve me më shumë se 70 për qind të pikëve dhe renditjen e tyre e bënë duke filluar nga kandidati me më shumë pikë. 16. Jo më shumë se tre (3) kandidatë dhe jo më pak se dy (2) kandidatë të vlerësuar nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 e më shumë për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe bashkë me poentimet e tyre, propozohen, për përzgjedhje përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Në rast të pikëve të barabarta zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e nenit 27 të Rregullores përkatëse për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës”.*

Duke marr parasysh faktin që në këtë proces nuk ka pasur së paku dy kandidatë fitues, atëherë edhe është bërë ndërprerja e procedurës, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh dispozitat e nenit 13 paragrafi 17 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, është përcaktuar se: *“17. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë përzgjedhë njërin prej kandidatëve të propozuar si në paragrafin 16 të këtij neni dhe e propozon për emërim në Qeveri. Përzgjedhja duhet të arsyetohet me shkrim”,* kështu që nuk ka qenë e mundur të aplikohet kjo dispozitë pasi që nuk kanë qenë dy kandidat fitues.

Ndërlidhur me pretendimit ankimore të ankuesit i cili pretendon se gjatë intervistës me gojë është diskriminuar dhe nuk është bërë vlerësimi në mënyrë reale, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi në testim me shkrim ka marr 35.6 pikë, ndërsa në intervistë me gojë ankuesi ka marr gjithsejtë 28.9 pikë ndërsa në total ka marr 64.5 pikë. Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka marr numrin e nevojshëm të pikëve për emërim respektivisht nuk ka marr 70 pikë, konkretisht Kolegji nuk ka evidentuar ndonjë diskriminim ndaj ankuesit sa i përket vlerësimit të intervistës me gojë, ngase intervista me gojë është proces diskrecional i Komisionit Shtetëror të Pranimit i cili bënë vlerësimin sipas përgjigjeve të kandidatëve dhe mbi bazën e procedurave nuk ka ndonjë mekanizëm ligjor për të argumentuar atë që pretendon ankuesi, si rezultat i kësaj e gjithë procedura e pranimit të hapur për pozitën “Sekretar i Përgjithshëm 1” për Ministrinë e Mbrojtjes është zhvilluar në pajtim me nenin 6, nenin 40 të Ligjit Nr. 06./L-114 për Zyrtarët Publikë, dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues dhe në këtë frymë janë respektuar parimet e menaxhimit të zyrtarëve publikë siç parashihet me nenin 7 të Ligjit Nr. 06./L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1196/2023, datë 27/10/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.